

Vlerësimi i nxënësve, i mësuesve dhe i shkollave**Fletë pune 12: Treguesit e cilësisë së EQD/EDNJ në një shkollë**

Dokumenti i Këshillit të Evropës "Sigurimi i Cilësisë së Edukimit për Qytetari Demokratike në Shkollë" përfshin një grup treguesish të ndarë në nëntema dhe përshkrues, të cilët pasqyrojnë një cilësi të dëshiruar të EQD/EDNJ në një shkollë. Këto kritere mund të përdoren për gjykim dhe vlerësim. Zbatimi i tyre do të ofrojë një krahasim ndërmjet gjëndjes së një shkolle në lidhje me EQD/EDNJ dhe synimeve të dëshiruara.

Tabela më poshtë, pjesë e dokumentit të sipërpërmendur, mund të përdoret për vlerësimin e gjëndjes së EQD/EDNJ në një shkollë në bazë të treguesve të cilësisë.⁴⁴

Fushat	Treguesit e cilësisë	Nëntemat
Kurrikula, mësimdhënia dhe të nxënësve	Treguesi 1 A ka të dhëna për vendin e duhur të EQD/EDNJ në objektivat e shkollës, politikat dhe planet kurrikulare?	<ul style="list-style-type: none"> Politikat e shkollës Planifikimi zhvillimit të shkollës në EQD/EDNJ EQD/EDNJ dhe kurrikula e shkollës Koordinimi i EQD/EDNJ
	Treguesi 2 A ka të dhëna të kuptimit të EQD/EDNJ nga nxënësit dhe mësuesit dhe të zbatimit të këtyre parimeve në praktikën e tyre të përditshme në shkollë dhe klasë?	<ul style="list-style-type: none"> Rezultatet e të nxënësve EQD/EDNJ Metodat dhe proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve Monitorimi i EQD/EDNJ
	Treguesi 3 A janë planifikimi dhe praktikat e vlerësimit brenda shkollës në harmoni me EQD?	<ul style="list-style-type: none"> Transparenca Drejtësia Përmirësimi
Etika dhe klima në shkollë	Treguesi 4 A i reflekton si duhet etika e shkollës parimet e EQD/EDNJ?	<ul style="list-style-type: none"> Aplikimi i parimeve dhe vlerave të EQD/EDNJ në jetën e përditshme Lidhjet dhe modelet e autoritetit Mundësitë e pjesëmarrjes dhe vetshprehjes Procedurat për zgjidhjen e konflikteve dhe trajtimi i dhunës, ngacmimit dhe diskriminimit, përfshirë politikat e disiplinës
Menaxhimi dhe zhvillimi	Treguesi 5 A ka të dhëna të udhëheqjes efikase të shkollës bazuar në parimet e EQD/EDNJ?	<ul style="list-style-type: none"> Stili i udhëheqjes Vendim marrja Ndarja e përgjegjësisë, bashkëpunimi dhe puna në grup Përgjigjja
	Treguesi 6 A ka shkollë një plan të mirë zhvillimi që reflekton parimet e EDC/HRE?	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja dhe përfshirja Zhvillimi profesional dhe organizues Menaxhimi i burimeve Vetë vlerësimi, monitorimi dhe llogaridhënia

(Këshilli i Europës, Qeverisja Demokratike e Shkollave, 2005, fq 58)

44. Kur u zhvillua ky instrument në vitin 2005, treguesit në tabelën e mësipërme u përshkruan si tregues të EQD. Shtesa EQD/EDNJ është bërë në këtë tabelë për këtë vëllim